DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

A-490242

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lëvizte i armatosur me makinë, arrestohet 27-vjeçari në Kurbin! Përplasi mjetin e policisë gjatë tentativë s për t'u larguar - Euronews Albania
ADRESA	`https://euronews.al/levizte-i-armatosur-me-makine-arrestohet-27-vjecari-ne-kurbin-perplasi-mjetin-e-policise-gjate-tentatives-per-tu-larguar/`
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	3 tetor 2026, 11:05:47 UTC *Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.*
DEKLARUAR NGA PORTALI	3 tetor 2026, 11:01:58 UTC *Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.*

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	`23859fc0542ff7d4768db1438f05f668aa05fc48ad9b366fd86706099ccd2b0f`
TEKSTI	`b6131865245bc6f7bb07572d8b605b9f3f626a03b1f824d6f43d2ffbbdfee485`
PAMJA	`6ddff0e2c1c6746a3305eec47bcf994431e9aad29d284b8cc87385177989f784`

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	`479084f0da049c7daf67ab4cc53418ed9ab6c1c040c833820a60aab3ba42872b`
E MËPARSHMJA	–
RRËNJA MERKLE	–
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende *Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.*

SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/479084f0da049c7daf67ab4cc53418ed9ab6c1c040c833820a60aab3ba42872b`

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

Lëvizte i armatosur me makinë, arrestohet 27-vjeçari në Kurbin! Përplasi mjetin e policisë gjatë tentativës për t'u larguar

3 Tetor 2026 | 13:01

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Një 27-vjeçar është arrestuar këtë të shtunë në Kurbin, pasi lëvizte i armatosur me automjet. Në vijim të kësaj, 27-vjeçari nuk i është bindur urdhrit të policisë për të ndaluar, duke përplasur automjetin e bluve, duke rrezikuar kështu jetën e punonjësve të Policisë dhe duke hedhur armën që mbante me vete.

Sipas raportimeve të policisë, ngjarja është regjistruar në lagjen "Zef Hoti", Mamurras, ku është bërë e mundur edhe kapja e E. Xh., 27 vjeç, të cilit iu sekuestruan arma e zjarrit, municion luftarak, automjeti dhe një palë targa.

Njoftimi i plotë i Policisë:

Qarkullonte me automjet i armatosur me armë zjarri, nuk iu bind urdhrit të punonjësve të Policisë për të ndaluar dhe tentoi të largohej, duke përplasur automjetin e shërbimeve të Policisë dhe rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë. Neutralizohet dhe vihet në pranga 27-vjeçari.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë, municion luftarak, automjeti dhe një palë targa.

Sektori për Krimet e Rënda, në bashkëpunim me Seksionin e Mbështetjes Operacionale në DVP Lezhë dhe Komisariatin e Policisë Kurbin, bazuar në informacionet e siguruara për një shtetas që qarkullonte i armatosur, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Target", në kuadër të të cilit u arrestua shtetasi:

– E. Xh., 27 vjeç, banues në Mamurras, Kurbin.

Ky shtetas u lokalizua në qytetin e Mamurrasit, duke qarkulluar me automjet. Sapo ka parë shërbimet e Policisë, ka vijuar lëvizjen me shpejtësi, duke përplasur automjetin e shërbimeve të Policisë dhe duke rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë, si dhe ka hedhur armën e zjarrit që mbante me vete.

Pas disa minutash ndjekjeje, në lagjen "Zef Hoti", Mamurras, u bë e mundur kapja dhe vënia në pranga e 27-vjeçarit.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme.

LAJMI I FUNDIT

12:41 **Deklarata e fortë e Dodik në tubimin e fundit parazgjedhor: Bosnja dhe Hercegovina është e vdekur**

12:37 **Zgjedhjet vendore 2027, KQZ letër partive: Votim dhe numërim elektronik në 3 ose 4 bashki të mëdha**

12:24 **Moti i ngrohtë zgjat sezonin, plazhet e Vlorës të mbushura me turistë edhe në tetor**

12:14 **Berisha për territorialen: Vendosa të këshillohem me aleatët për këtë çështje, propozimi i Ramës është për qëllime elektorale**

11:56 **Presidentja e Moldavisë: 5 dronë rusë shkelën hapësirën ajrore dhe shpërthyen në territorin tonë**

11:31 **Kë përfaqësojnë partitë "ruse" në Serbi?**

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | POLITIKË | VENDI

Zgjedhjet vendore 2027, KQZ letër partive: Votim dhe numërim elektronik në 3 ose 4 bashki të mëdha

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KQZ përmes një letre zyrtar këtë të shtunë, kërkon që për zgjedhjet e ardhshme lokale procesi i votimit dhe numërimit elektronik...

12:37 | 03/10/2026

AKTUALITET | VENDI

Moti i ngrohtë zgjat sezonin, plazhet e Vlorës të mbushura me turistë edhe në tetor

Moti i ngrohtë dhe temperaturat që arrijnë deri në 30 gradë kanë bërë që edhe në 3 tetor, plazhet e Vlorës të vijojnë të frekuentohen...

12:24 | 03/10/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Berisha për territorialen: Vendosa të këshillohem me aleatët për këtë çështje, propozimi i Ramës është për qëllime elektorale

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, këtë të shtunë po zhvillon një takim me aleatët e Federatës së Opozitës së Bashkuar, ku në fokus është...

12:14 | 03/10/2026

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.